



**Hapet Thirrja për mobilitete stafi të UPT-së  
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus +  
në AGH University of Science and Technology, Poloni.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në AGH University of Science and Technology.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:** Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie dhe pjesëmarrje në *4th Erasmus+ International Staff Week*.

**Numri total i stafit akademik për mësimdhënie: 4**

**Koha e kryerjes së mobilitetit: 13 – 17 janar 2025**

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës\*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës\*\*;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching) për stafin akademik në universitetin pritës\*\*\*.

*\*Plani i mobilitetit për, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*\*\*Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf akademik në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

*\*\*\* Mobility Agreement for Teaching për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 4.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

**Key Action 1**  
**– Mobility for learners and staff –**



---

Personat e interesuar do të njoftohen në vijim për detajet lidhur me procesim e mësimdhënies dhe axhendën e aktivitetit.

***Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 8 nantor 2024, ora 12.00.***

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) , [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al) .